

25/10/2024
02/1908

ANEKS MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
SHTIMEIŠTIMLJE

Në mes

- 1) Komunës së Shtimes, e Përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Z. Qemajl Aliu (në tekstin e mëtejme Komuna),
- 2) Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, i përfaqësuar nga Z. Gojart Bajrami, drejtor dhe
- 3) Organizatës Për Zhvillim Rural (OZHR) "Mëshqerra" - Prishtinë, me adresë: Ulpiana U1 H6/5, e Përfaqësuar nga Znj. Florentina Kida Gërguri, drejtor.

Neni 1

Qëllimi

Komuna e Shtimes dhe OZHR "Mëshqerra" kanë bërë këtë Aneks marrëveshje për vazhdimin e bashkëpunimit bazuar në marrëveshje e bashkëpunimit të datës: **02.11.2023**, me numër protokolli; **02/973** (33 mëshqerra barrëse)

OZHR "Mëshqerra" do të mbështesë edhe me 27 (njëzeteshtatë) mëshqerra tjera për fermerët e komunës së Shtimes (në total OZHR "Mëshqerra" do të shpërndajë 60 mëshqerra barrëse (Tetor – Nëntor 2024).

Komuna e Shtimes do të participojë edhe me 27.000,00 (njëzet e shtatë mijë) Euro tjera në projekt, ku në total komuna do të participojë me 60.000,00 (gjashtëdhjetë mijë euro) apo 29.42% të vlerës totale të projektit. OZHR "Mëshqerra" do të participoj me kafshë, mëshqerra barrëse të racës Hollshtajn, të cilat kanë vlerë 120.000,00 (njëqind e njëzet mijë euro) apo 58.82% të vlerës totale të projektit. Ndërsa fermerët përfitues do të participojë 24.000,00 (njëzetë e katër mijë euro) apo 11.76% të vlerës totale të projektit.


Neni 2

Obligimet e Komunës


Komuna e Shtimes zotohet se bashkëfinancimin e projektit do ta bëjë në dy këste si vijon: Gjatë vitit 2025 (muaji Prill), do të transferoj mjetet në xhirollogarinë e OZHR "Mëshqerra" (Raiffeisen Bank 1501130000416395), shumë prej 30,000.00€ (kësti i parë), ndërsa gjatë vitit 2026, komuna do të transferoj shumë prej 30,000.00€ (muaji Prill) kësti i dytë, për implementimin 3 vjeçar të projektit.

Kohëzgjatja e projektit, obligimet tjera të palëve dhe nenet tjera janë të njëjta bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar me datës: **02.11.2023**, me numër protokolli; **02/973**.

Më:


Kryetari i Komunës
Z. Qemajl Aliu

DBZHR, Shtime
Z. Gojart V. Bajrami



Më:

25.10.2024

OZHR "Mëshqerra"

Zj. Florentina Kida Gërguri

